

## ÇELO HOXHA

### ZHVILLIMET POLITIKE NË EVROPËN LINDORE (1953-1960)

Pas vdekjes së Stalinit (5 mars 1953), udhëheqja sovjetike u përball me dy çështje themelore: kush do të ishte pasuesi i tij dhe konsolidimi i gjendjes në Perandorinë Sovjetike. Pavarësisht luftës së brendshme për pushtet mes tyre, ku përqendruan energjitë kryesore, ata ishin të bashkuar në mendimin se politika e brendshme e vendeve satelite kishte nevojë për ndryshime, sepse ato e kishin tejkaluar masën në ndërtimin e shteteve të tyre të tipit stalinist.<sup>1</sup>

Në vlerësimin e udhëheqjes së re sovjetike, gjendja ekonomike e vendeve të Bllokut Komunist ishte në prag katastrofe dhe, nëse nuk merreshin masa, parashikoheshin trazira të mëdha.<sup>2</sup> PKBS kishte burime të mjaftueshme informacioni për të formuar një pamje të qartë të situatës në vendet satelite. Në Hungari, dhe kjo mund të thuhet për të gjitha vendet, procesverbalet e mbledhjeve të organizatave kryesore partiake dërgoheshin në Moskë, së bashku me raporte prezantimi dhe përmbledhëse të herëpashershme. Ajo merrte informacion nga këshilltarët sovjetikë që punonin në ministri të ndryshme të këtyre vendeve. Ambasadat sovjetike mbanin kontakte me një numër të shumtë informatorësh, shumica e të cilëve ishin kthyer nga emigracioni në Bashkimin Sovjetik.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> János Rainer, "The New Course in Hungary in 1953", Working Paper No. 38, f. 7, në: *Cold War International History Project*, Washington DC, June 2002, f. 7. Adresa (10 janar 2017): <https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/ACFAF2.pdf>

<sup>2</sup> Po aty, f. 16; shih: Ana Lalaj, "1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë: ose ndryshime ose katastrofë", në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2010, f. 223.

<sup>3</sup> Ky paragraf është formuluar bazuar në një artikull ku flitet për rastin hungarez, por mund të thuhet me siguri që gjendja ishte e njëjtë për të gjitha vendet komuniste të Evropës Lindore. Për rastin shqiptar, për shembull, e dimë që drejtuesit e PKSH raportonin me dëshirën e tyre tek ambasadori sovjetik në Tiranë, por ambasadori sovjetik, nëse dëshironte, mund të thërriste në ambasadë cilindo zyrtar, dhe ai ose ajo i bindej pa hezitim. Shih: J. Rainer, "The New Course...", f. 9.

### **Paralajmërimi i Moskës për katastrofë në vendet satelite**

Në qershor të vitit 1953, sovjetikët thirrën me urgjencë në Moskë drejtuesit kryesorë të Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë, të Partisë së Popullit Punëtor Hungareze, të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe, në vjeshtë, udhëheqësit rumunë, çekë e polakë, të cilëve u thanë se, nëse nuk merrnin masa në fushën ekonomike, vendet e tyre i priste katastrofa. Rruga më e përshtatshme, sipas sovjetikëve, ishte një paketë ndërhyrjesh të ngutshme për të shmangur trazirat, të cilat mund të përbënin rrezik për vetë Kampin Socialist.<sup>4</sup> Udhëheqja sovjetike u kërkoi vendeve satelite që buxhetet e tyre të shkonin më shumë për plotësimin e nevojave të popullsisë me produkte ushqimore dhe mallra konsumi, të zbatonin politika më liberale tregu dhe për shërbimet ndaj qytetarëve, të ndërprisnin krijimin e kooperativave bujqësore, të amnistionin në masë të arratisurit dhe të burgosurit, të mbyllnin kampet e punës dhe të internimit, dhe të liberalizonin kufijtë midis tyre.<sup>5</sup> Po atë muaj që drejtuesit sovjetikë thirrën në Moskë përfaqësuesit e tre vendeve të para, trazirat e paralajmëruara prej tyre nisën të konkretizoheshin, me protestat kundër reformës monetare në Çekosllovakia dhe protestat kundër reformës për rritjen e normave të punës në Gjermaninë Lindore dhe me protestat antisovjetike në Poloni. Kriza preku dhe Rumaninë e Bullgarinë, ndërsa në Hungari çoi në ndërrimin e qeverisë.<sup>6</sup>

#### *a) Kritikta e Moskës për Gjermaninë Lindore*

Në vlerësimin e sovjetikëve, jeta e popullit në Gjermaninë Lindore ishte përkeqësuar për shkak të masave politike dhe ekonomike të gabuara. Dëshmi e kësaj ishte numri i lartë i njerëzve që arratiseshin nga vendi për në Gjermaninë Perëndimore; vetëm në tre muajt e parë të atij viti ishin larguar 120 mijë persona. Shkak për gjendjen e krijuar ishte vendimi i Kongresit II SED (korrik 1952) për shpejtimin e ndërtimit të

<sup>4</sup> A. Lalaj, “1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë...”, f. 223.

<sup>5</sup> Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e '56-ës*, Tiranë: Infobotues, 2015, f. 32.

<sup>6</sup> Péter Vámos, “Sino-Hungarian Relations and the 1956 Revolution”, Working Paper, 54, në: *Cold War International History Project*, Washington DC, November 2006, f. 2. Adresa (3 mars 2017): [https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/WP54\\_Final2.pdf](https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/WP54_Final2.pdf)

socializmit pa ekzistencën e kushteve reale, të brendshme dhe të jashtme. Masat social-ekonomike të ndërmarra në këtë drejtim ishin: ndërtimi i detyruar i industrisë së rëndë, të cilës i mungonte lënda e parë; kufizimi i shpejtë i pronës private dhe heqja e lejeve të punës për personat e sektorit privat. Krijimi i nxituar i kooperativave pa bazën e nevojshme në fshatra kishte çuar në vështirësi të furnizimit të popullsisë me mallra dhe ushqime, në zhvleftësimin e monedhës, dhe në shkatërrimin e sipërmarrësve të vegjël etj. Fshatarët kishin filluar të braktisnin tokën dhe të arratiseshin në Gjermaninë Perëndimore, duke lënë pa punuar rreth 550 mijë hektarë tokë. Sipas sovjetikëve, kjo situatë ishte një kërcënim për RDGJ dhe korrigjimi i saj kërkonte që: a) të njihej si gabim kursi i ndërtimit të detyruar të socializmit; b) të ndërpritej krijimi artificial i kooperativave bujqësore, të cilat kishin rezultuar pa bazë dhe kishin ngjallur pakënaqësi të fshatarësia; të verifikoheshin të gjitha kooperativat ekzistuese të prisheshin ato që nuk ishin krijuar mbi bazë vullnetare dhe ato që nuk ishin fitimprurëse; në kushtet aktuale shiheshin me interes vetëm kooperativat ku fshatarët bashkonin tokën, pa kolektivizuar mjetet e punës; c) forcimi i vazhdueshëm i SMT-ve; d) anulimi i masave të kufizimit ose zvogëlimit të kapitalit të vogël dhe të mesëm si një masë e parakohshme; f) marrja e masave për përmirësimin e sistemit financiar, uljen e shpenzimeve administrative, forcimi i monedhës vendase, markës; e) marrja e masave për forcimin e ligjit dhe garantimin e të drejtave demokratike të qytetarëve, heqja dorë nga ndëshkimet e rënda të panevojshme, rishikimi i dosjeve të qytetarëve të ndaluar me synim lirin e të dënuarve pa fakte të mjaftueshme, në përputhje me këtë pikëpamje të bëheshin ndryshime në kodin penal; f) të hiqej dorë nga masat e ftohta administrative dhe të punohej që masat e marra nga qeveria të kuptoheshin dhe të mbështeteshin nga populli; g) të hiqej dorë nga ndërhyrja në punët e Kishës, të anuloheshin masat e dëmshme ndaj Kishës dhe klerikëve si konfiskimi i shoqatave bamirëse, ndalimi i subvencionit shtetëror për Kishën, etj.; si dhe masa të tjera në lidhje me kushtet specifike të Gjermanisë, si një shtet i ndarë.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> "USSR Council of Ministers Order, 'On Measures to Improve the Health of the Political Situation in the GDR,'" June 02, 1953, Wilson Center. Document provided by Leonid Reshin (Moscow). Translated by Benjamin Aldrich-Moodie. The German version of this document from the SED archives was originally published by Rolf Stöckigt, "Ein Dokument von grosser historischer Bedeutung vom Mai 1953," *Beträge zur Geschichte der Arbeiterbewegung* 32:5 (1990), 648-654.

Më 6 qershor u mblodh Byroja Politike e SED-it në një takim të jashtëzakonshëm, ku diskutuan rreth vizitës së delegacionit në Moskë, dhe u vendos a) të hartohet një raport me frymë autokritike që do t'i paraqitet KQ të PKBS; b) krijimi i një komisioni për kryerjen e reformës së organizimit të Byrosë dhe Sekretariatit; c) rishikimin e menjëhershëm të një posteri propagandistik; d) fillimin e bisedimeve me krerët e Kishës; e) mos të merreshin masa kundër institucioneve fetare në asnjë mënyrë; ë) pronat fetare të konfiskuara t'u ktheheshin ish-pronarëve; f) subvencionimet për kishën do të paguheshin; g) kampet karantinë të krijuara për refugjatët e krijuar do të prisheshin; shpërbërja e kampeve verore për stërvitjen fizike të anëtarëve dhe kandidatëve të partisë.<sup>8</sup> Më 11 qershor, në Gjermaninë Lindore u botua një komunikatë në lidhje me Kursin e Ri, paketa e parë me masa korrigjuese që u shfaq në Bllokun Lindor.<sup>9</sup>

*b) Kritikkat e Moskës për Hungarinë*

Në takimin me delegacionin hungarez, sovjetikët diskutuan zhvillimet në fushën ekonomike, zgjedhjen e zyrtarëve dhe problemin e akteve arbitrare. Takimi nuk ishte thjesht një bisedë për shkëmbim mendimesh, por dhe diskutim për mënyrën e korrigjimit të gabimeve. Ata kritikuan kooperativat bujqësore, braktisjen e tokës bujqësore nga bujqit, detyrimet e mëdha të furnizimeve për fshatarët dhe për persekutimin e tyre.<sup>10</sup>

Sovjetikët kritikuan numrin e madh të proceseve gjyqësore kundër individëve në Hungari, që, sipas tyre, ishin të papranueshme; ishin kryer 1.5 milionë procese gjyqësore, shumica për çështje të vogla, në një popullsi 9.5 milionë banorë. Ata urdhëruan bashkimin e shërbimeve sekrete me Ministrinë e Brendshme dhe kritikuan faktin që vetë Rakosi,<sup>\*</sup> sekretar i përgjithshëm i partisë dhe kryeministër, kishte ndërhyrë në

<http://digitalarchive.wilsoncenter.org/document/110023>

<sup>8</sup> "SED CC Politburo Minutes Discussing Moscow's Directives for the New Course," June 06, 1953, History and Public Policy Program Digital Archive, SAPMO-BArch, DY 30 2/21. Translated by Christian Hetzner and Christian Ostermann.

Adresa (9 janar 2017): <http://digitalarchive.wilsoncenter.org/document/112169>

<sup>9</sup> J. Rainer, "The New Course...", f. 13.

<sup>10</sup> Po aty, f. 14.

\* *Matias Rakosi (1892-1971)* - Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Hungareze (1945-1948) dhe pastaj i Partisë së Popullit Punëtor Hungarez (1948-1956).

hetime të veçanta dhe kishte dhënë urdhra personalisht për përdorimin e dhunës fizike.<sup>11</sup>

Në rastin e hungarezëve, sovjetikët u shprehën për korigjimin e përjashtimeve të vitit 1949 dhe kërkuan që Imre Nagi, një nga viktimat dhe anëtar i delegacionit në Moskë, të merrte detyrën e kryeministrit, ndërsa Rakosi të mbante vetëm postin e kreut të partisë. Në këndvështrimin e sovjetikëve çështja e udhëheqjes së mbingarkuar me poste ishte problem në gjithë vendet socialiste. Sjellja autokratike, e cila, lihej të kuptohej se buronte nga veprimtaria e Stalinit, ishte fenomen i përhapur në të gjitha vendet dhe duhej korigjuar.<sup>12</sup>

Sovjetikët kritikuan masa të caktuara që kishin dëmtuar standardin e jetesës së popullsisë.

Ata kritikuan planifikimin ekonomik për teprime. E quajtën të panevojshëm planin për ndërtimin e industrisë së hekurit dhe çelikut, sepse Hungaria nuk kishte burime të vetat për lëndë të parë. Kritikuan gjithashtu disa investime të mëdha, si një fonderi e madhe dhe një hekurudhë nëntokësore. Kolektivizimi i bujqësisë në Hungari, sipas sovjetikëve, ishte bërë i nxituar, ndërkohë që nuk kishte bazë ekonomike.<sup>13</sup>

Rakosi, sipas sovjetikëve, duhet të nxirrte mësim të thella nga takimi dhe të kuptonte që duhej krijuar udhëheqja kolektive. Kjo nuk nënkuptonte ndryshime radikale, veç duhej zgjeruar sfera e udhëheqësve të përgjegjshëm, duke vendosur në poste kryesore njerëz me reputacionin e nevojshëm, dhe të ndahej puna e partisë me të qeverisë. Qeveria duhej të vendoste për çështjet ekonomike, ndërsa partia të merrej me trajnimin e komunistëve. Sovjetikët kërkuan që Bashkimi Sovjetik të ruante të drejtën e fjalës për çfarë ndodhte në Hungari edhe nëse tërhiqeshin forcat ushtarake të tyre. Hungarezët i propozuan masat e ndryshimit pa u larguar nga Moska dhe dokumenti që u paraqit mori miratimin e sovjetikëve.<sup>14</sup>

### *c) Kritikën e Moskës për Shqipërinë*

Gjendja ekonomike e Shqipërisë ishte, sipas sovjetikëve, jashtëzakonisht e keqe. Ata i thanë delegacionit shqiptar, i kryesuar nga

<sup>11</sup> J. Rainer, "The New Course...", f. 15.

<sup>12</sup> Po aty, f. 15-17.

<sup>13</sup> Po aty, f. 15-16.

<sup>14</sup> Po aty, f. 18-23.

Enver Hoxha, se qeveria nuk e linte fshatarin të ngrinte ekonominë e tij; sapo fshatari e përmirësonte pak gjendjen, thanë sovjetikët, qeveria nxirrte ligje dhe urdhëresa për t'i marrë mallin. Sovjetikët e konsideronin grabitje faktin që qeveria i merrte fshatarit 25 për qind të mallit taksë në natyrë. Shqipëria, u thanë sovjetikët shqiptarëve, kishte 25 për qind bagëti më pak se para lufte dhe numri i tyre vinte në rënie; ajo kishte mijëra ekonomi pa kafshë pune dhe, ato kafshë pune që kishin, nuk i ushqenin. Gjendja e mjeruar e bujqësisë, mendonin sovjetikët, ishte arsyeja pse Shqipëria importonte me dhjetëra mijë tonelata drithëra në vit.<sup>15</sup>

Edhe situata financiare e Shqipërisë, nga këndvështrimi i sovjetikëve, ishte e keqe. Qarkullimi i monedhës në vend ishte shtuar me 40 për qind, ndërsa xhiroja e tregtisë vetëm 26 për qind. Sipas tyre, qeveria shqiptare nuk dinte të bënte tregti, ajo importonte me çmime të larta, duke detyruar dyqanet të mbylleshin, dhe, me masat e dëmshme që kishte marrë për çmimet e tregtisë, kishte nxitur tregun e zi. Për pasojë, privati nuk kishte leverdi të shiste, dhe ata tregtarë që kishin mbetur preferonin tregun e zi. Sovjetikët e kritikuan kryeministrin shqiptar për ndërtimet kolosale që kishte ndërmarrë qeveria, ndërkohë që mungonte krahu i punës, dhe, në përpjekje për të gjetur krahu pune në fshat, ajo kishte dëmtuar bujqësinë. Në gjykimin e sovjetikëve, për industrinë qeveria shqiptare ishte bazuar në llogari jo në përputhje me kushtet e vendit. Ajo kishte nisur ndërtimin e hidrocentralit mbi lumin Mat, ndërsa sovjetikët mendonin se Shqipëria nuk kishte nevojë për gjithë atë energji elektrike, sepse fabrikat e reja që ishin ndërtuar kishin TEC-et e tyre, të cilat prodhonin energji të mjaftueshme. Sovjetikët ishin kundër disa fabrikave të planifikuara për ndërtim, si ajo e çelikut, letrës, qelqit apo rafinerisë. Për fabrikën e rafinerisë, për shembull, ata mendonin se Shqipëria nuk ishte në gjendje ta furnizonte me naftë. Ata shikonin më të arsyeshëm zgjerimin e rafinerive ekzistuese.<sup>16</sup>

Në lidhje me administratën, sovjetikët i treguan Hoxhës shifra që ai i pranoi dhe i konsideroi dhe vetë si “vërtetë skandaloze.” Ata i thanë që Shqipëria kishte një administratë që mbahej në kurriz të fshatarësisë. Shqipëria kishte atë kohë 18 ministri, ndërsa asaj i mjaftonin, sipas sovjetikëve, vetëm 3 ose 4. Ata urdhëruan zhdukjen e të gjitha drejtorive

<sup>15</sup> A. Lalaj, “1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë...”, f. 223-247.

<sup>16</sup> Po aty.

“që keni krijuar,” dhe ndjekjen e shembullit sovjetik që kohët e fundit kishin bërë shkurtime në institucione. Ata ia thanë hapur Hoxhës se ai dhe disa zyrtarë të tjerë, mbanin shumë poste. Vetë Hoxha ishte sekretar i Përgjithshëm i partisë, ministër i Mbrojtjes, ministër i Punëve të Jashtme, dhe kryetar i Frontit Demokratik. Sovjetikët i kërkuan që të hiqte dorë nga disa prej posteve dhe t’ua kalonte ato “shokëve” të tjerë që puna të ecte përpara.<sup>17</sup>

Sovjetikët i kërkuan Hoxhës të bënte ndryshime në politikën e jashtme, sepse deri atëherë gjithçka që ishte bërë kishte synuar ashpërsimin me fqinjët. Sovjetikët e pranuan që ky qëndrim i shqiptarëve ishte ndikuar edhe nga politika e jashtme e BS, por tani Shqipëria duhej t’i përmirësonte marrëdhëniet me fqinjët e saj – Greqi, Itali, Jugosllavi. Në takim u prek dhe çështja e marrëdhënieve të qeverisë me besimet fetare, por Hoxha thotë në takimin e Byrosë Politike se Beria u tha që “lërimi hoxhallarët të bërtasin”. Nga takimet me gjermanët dhe hungarezët mësojmë që sovjetikët kanë qenë më të detajuar në lidhje me fenë, duke kërkuar kthimin e pasurive të konfiskuara, vazhdimin e subvencionimit nga shtetit etj.

Byroja Politike e PPSH nuk i kaloi direktivat e Moskës për diskutim në KQ të PPSH, me justifikimin e Hoxhës se nuk ishin të aftë për një analizë “të thellë të situatës së fshatarësisë,” por që dukej më shumë një taktikë për shmangien e përballjes me përgjegjësinë.<sup>18</sup> Më 22 qershor, Byroja mori vendimin për “korrigjimin e disa gabimeve në politikën ekonomike sidomos në drejtim të fshatarësisë dhe për forcimin e gjendjes së brendshme,” i cili pasqyronte të gjitha urdhrat e sovjetikëve. Vendimi e ngarkoi qeverinë që: a) brenda dy ditëve të falte të gjithë detyrimet e prapambetura nga vitet 1949-1952, në drithëra, mish, vezë, fasule, oriz etj.; b) deri më 5 korrik të mbaronte studimi për uljen e detyrimeve të gjithë artikujve bujqësorë e blegtoralë, sidomos në zonat kufitare dhe malore; c) qeveria dhe Ministria e Bujqësisë të merrnin masa konkrete për ndërtimin e veprave të vogla, por me rezultate imediate për fshatarësinë; d) të forcoheshin kooperativat ekzistuese dhe të frenohej përkohësisht krijimi i kooperativave të reja deri në plotësimin e kushteve; e) të merreshin masa për lehtësimin e fshatarësisë dhe prodhuesve të vegjël nga taksat; të rishikoheshin rrogat e punëtorëve dhe nëpunësve të

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> Po aty, f. 242.

vendit, me vëmendjen që rrogat e minatorëve dhe punëtorëve të naftës të ishin më të larta se rrogat e punëtorëve të industrisë. Vendimi pasqyronte gjithashtu urdhrin e sovjetikëve për shkurtimin e investimeve, administratës dhe forcave të armatosura. Disa vepra të planifikuara për pesëvjeçarin 1951-55 u hoqën nga plani i investimeve, administrata do të shkurtohej jo më pak se 50 për qind dhe numri i ministrive do të ulej nga 18 në 6 deri në 9; kryesia e Këshillit të Ministrave të suprimohej dhe numri i zëvendëskryeministrave të zbritesh nga 6 në dy. Edhe ndryshimet në ushtri parashikoheshin të bëheshin sipas këshillës së sovjetikëve: spastrim “i elementëve të padëshirueshëm” dhe rikthim në parti të oficerëve që kishin “gabuar” në të shkuarën, por që më vonë ishin korrigjuar. Për politikën e jashtme vendimi thoshte, pa shumë detaje, që “të ecet drejt kombinimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit tonë, dhe në radhë të parë me shtetet fqinje Itali, Jugosllavi dhe Greqi.”<sup>19</sup>

Më 1 gusht 1953, Enver Hoxha krijoi qeverinë e re, e cila reflektonte disa ndryshime, sipas këshillave sovjetike. Hoxha mbajti postin e kryeministrit, por hoqi dorë nga Ministria e Jashtme dhe e Mbrojtjes. Nga 6 zëvendëskryeministra mbetën 2, dhe numri i ministrive zbriti nga 18 në 11, megjithëse jo 9 ose 6 që premtonte Hoxha apo 3 ose katër që sugjeruan sovjetikët.<sup>20</sup> Hoxha, vërenin asokohe studiuesit e çështjeve të Evropës Lindore, e zbatoi me ngadalësi parimin e udhëheqjes kolektive dhe ishte udhëheqësi i fundit nga vendet satelite të BS në zbatimin e parimit të ndarjes së partisë nga qeveria, më 20 korrik 1954.<sup>21</sup> Në këtë periudhë në Shqipëri zyrtarët e lartë hoqën uniformën ushtarake në daljet publike.

Ndryshe nga partia e Gjermanisë Lindore, e cila botoi një komunikatë për kursin e ri, Enver Hoxha kërkoi që gjithçka të mbahej sekret dhe grupet e punës të porositeshin “se për çdo fjalë të dalë prej tyre do të ketë pushkatim.”<sup>22</sup>

<sup>19</sup> Po aty, f. 245-247.

<sup>20</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*..., 2166.

<sup>21</sup> Danniell Norman, “Albania: A Communist Colony”, *Problems of Communism*, March 1956, Washington DC (USA): Documentary Studies Section, International Information Administration, pp. 27-28. Adresa (22 dhjetor 2016): <http://www.unz.org/Pub/ProblemsCommunism-1956mar-00034>

<sup>22</sup> A. Lalaj, “1953 – Udhëheqësit e rinj sovjetikë paralajmërojnë...”, f. 225.

### **Riafrimi i vendeve të Bllokut Komunist me Jugosllavinë**

Udhëheqja e re sovjetike e konsideroi përjashtimin e Jugosllavisë nga Informbyroja (1948) një gabim që kishte dëmtuar bllokun socialist dhe që prej tij kishte përfituar vetëm Perëndimi.<sup>23</sup> Veç goditjes së kultit të Stalinit, rikthimi i Jugosllavisë në Kampin Socialist ishte qëllimi tjetër i madh i Hrushovit,<sup>24</sup> ndaj ai ishte i pari që mori iniciativën me një letër dërguar Titos më 22 qershor 1954; deri në shtator ata këmbyen tre letra. Tito u tregua i gatshëm për normalizimin e marrëdhënieve, por sipas kushteve të tij, që kjo të mos cenonte pozicionin e Jugosllavisë në botë, duke nënkuptuar pavarësinë dhe marrëdhëniet e saj me vendet perëndimore.<sup>25</sup> Si shenjë e dëshirës për përmirësimin e marrëdhënieve, sovjetikët mbyllën radion Jugosllavia e Lirë, radio emigrantësh jugosllavë me frymë kundër regjimit të Titos; në BS dhe vendet satelite, me përjashtim të Shqipërisë, u hoq bllokimi i valëve të Radio Beogradit; shtypi sovjetik nisi të fliste për Titon me dashamirësi dhe agjencia e lajmeve TASS filloi botimin e komenteve jugosllave për çështje të ndryshme ndërkombëtare, me përjashtim të atyre që binin ndesh me këndvështrimin e Moskës.<sup>26</sup> Vendet satelite ndoqën shembullin e Moskës, me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me Jugosllavinë.<sup>27</sup>

Më 26 maj 1955, Hrushovi vizitoi Jugosllavinë dhe deklaroi se i hidhte poshtë me vendosmëri ato që kishin ndodhur mes dy vendeve pas vitit 1948. Pasi firmosi marrëveshjen me Jugosllavinë, delegacioni

<sup>23</sup> Richard Paul Kirby, "Tito and Khrushchev: Harmony and Discord" (tezë masteri) (Carleton University, Ottava, Canada: 1966), 17. Adresa (23 janar 2017): [https://curve.carleton.ca/system/files/etd/189c7b96-a6e8-482a-9f23-e5d03c2413d5/etd\\_pdf/65b4807375777a97928e252ce0aeeb3/kirby-titoandkhrushchevharmonyanddiscord.pdf](https://curve.carleton.ca/system/files/etd/189c7b96-a6e8-482a-9f23-e5d03c2413d5/etd_pdf/65b4807375777a97928e252ce0aeeb3/kirby-titoandkhrushchevharmonyanddiscord.pdf)

<sup>24</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 33.

<sup>25</sup> Svetozar Rajak, "The Tito-Khrushchev Correspondence," 1954, *Cold War International History Project Bulletin*, Issue 12/13, f. 321; shih: Svetozar Rajak, "Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957: Normalization, Comradeship, Confrontation", (tezë doktorature), London School of Economics and Political Science, Londër, February 2004, f. 110. Adresa (23 janar 2017): <http://etheses.lse.ac.uk/2525/1/U615474.pdf>

<sup>26</sup> S. Rajak, "Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957...", f. 122-123.

<sup>27</sup> Po aty, f. 125-126.

sovjetik shkoi në Sofje dhe Bukuresht për të shpjeguar qëndrimin e ri të Moskës. Aty Hrushovi e bëri të qartë se vendet e tjera të Bllokut duhet të ndiqnin politikën e Moskës.<sup>28</sup> Te drejtuesit e partive satelite nuk kishte entuziazëm për normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, por dhe Tito e bashkëpunëtorët e tij ishin po aq jo entuziastë për rivendosjen e marrëdhënieve me ta, disa prej të cilëve ishin ngritur në krye të partive të tyre me organizimin e gjyqeve të fabrikuara antijugosllave në periudhën 1948-53. Me disa nga këta drejtues, si Rakosin e Hungarisë dhe Hoxhën e Shqipërisë, që Tito i konsideronte të padurueshëm, ai nuk pranonte të komunikonte fare. Me porosi të Stalinit, në gjithë Evropën Lindore shumë komunistë ishin dënuar si titistë dhe spiunë të Titos, mes tyre bënë pjesë figura të respektuara në botën komuniste si Gomulka në Poloni dhe Kadari në Hungari. Disa nga “titistët”, si Lazlo Rajku në Hungari, Trajko Kostovi në Bullgari, Robert Slanski në Çekosllovakia dhe Koçi Xoxe në Shqipëri u ekzekutuan.<sup>29</sup>

Ndjesa e Hrushovit mund të ishte e sinqertë, por Tito nuk u mjaftua me aq. Ai kërkoi kompensime për dëmin ekonomik që i ishte shkaktuar Jugosllavisë prej përjashtimit nga Blloku Komunist. Bashkimi Sovjetik ra dakord për t'i dhënë 250 milionë dollarë kredi ekonomike dhe të zhvillonte programin e energjisë atomike të Jugosllavisë. Çekosllovakia pranoi t'i paguante një dëmshpërblim prej 50 milionë dollarë të shtrirë në 10 vjet. Në total gjithë Blloku Komunist i dha Jugosllavisë rreth 300 milionë dollarë kredi të lehta. Bashkimi Sovjetik i fali dhe borxhet para 1948-ës, rreth 90 milionë dollarë.

Pas vizitës së Titos në Bashkimin Sovjetik (2-23 qershor 1956), Jugosllavia përmirësoi ndjeshëm marrëdhëniet me Poloninë, Çekosllovakinë dhe Rumaninë, por jo me Bullgarinë, Hungarinë dhe Shqipërinë. Në lidhje me Hungarinë, Tito deklaroi se para normalizimit të marrëdhënieve duhej të zgjidheshin disa çështje si rehabilitimi i Lazlo Rajkut, amnisti për gjithë të burgosurit politikë jugosllavë, trajtimin e drejtë të minoritetit jugosllav dhe pagimin e një dëmshpërblimi financiar nga ana e Hungarisë. Kërkesat ishin pak a shumë të njëjta edhe për vendet e tjera. Hungaria i liroi jugosllavët e burgosur dhe i lejoi të jetonin ku të dëshironin, në Hungari ose Jugosllavi; gjendja e minoritetit jugosllav nisi të përmirësohet dhe marrëveshja për dëmshpërblimin u arrit

<sup>28</sup> R. P. Kirby, “Tito and Khrushchev...”, f. 21, 27-28.

<sup>29</sup> S. Rajak, “Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957...”, f. 127.

më 1956. Edhe Rumania liroi mijëra të burgosur jugosllavë dhe i lejoi të ktheheshin në rajonin e Banatit.<sup>30</sup>

Normalizimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë ishte çarja e parë në trashëgiminë e Stalinit jashtë Presidiumit të PKBS, që u thellua me luftën kundër kultit të individit në Kongresin XX. Kritikkat kundër Stalinit nisën nga debati për të gjetur se kush ishte përgjegjës për prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë.<sup>31</sup> Tito dëshironte që regjimet staliniste në vendet satelite të zëvendësoheshin me regjime më tolerante, por jo zëvendësimin e regjimit socialist me atë kapitalist në këto vende.<sup>32</sup> Ai e kishte të vështirë të krijonte marrëdhënie normale me vende si Hungaria dhe Shqipëria. Marrëdhëniet me Hungarinë nuk patën ndonjë përmirësim të dukshëm edhe pasi marrëveshja u arrit sipas kushteve të Titos, dhe shkak për këtë ishte antipatia e dy liderëve për njëri-tjetrin, e cila ishte kthyer në një armiqësi gati personale. Për Rakosin, Tito ishte “një qen i imperializmit”, ndërsa Rakosi për Titon ishte “një njeri i pandjeshëm, kokëfortë, i pamëshirshëm dhe i pashpirt”.<sup>33</sup>

Megjithatë, viktima e parë e afrimit të Moskës me Beogradin nuk ishte Rakosi apo Hoxha, por kryeministri bullgar. Në prill, komunistët e Sofjes kërkuan rehabilitimin e Kostovit. Kryeministri Vulko Çervenkov dha dorëheqjen me këtë rast dhe vendin e tij e zuri një i dënuar me grupin e Kostovit.<sup>34</sup>

Enver Hoxha ishte më kundërshtuesi në gjithë Bllokun Komunist ndaj afrimit me Jugosllavinë. Shqipëria, ndryshe nga gjithë vendet e tjera, kishte pasur një lidhje shumë të ngushtë me Jugosllavinë deri më 1948.

Komunistët jugosllavë kishin luajtur një rol vendimtar në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë më 1941, në organizimin e forcave partizane, në luftën kundër kundërshtarëve politikë brenda Shqipërisë, në krijimin e institucioneve shtetërore pas luftimeve. Jugosllavia kishte shërbyer si mbrojtëse në arenën ndërkombëtare dhe Ministria e Jashtme e saj kishte mbuluar dhe shumë shërbime për Shqipërinë ndërkohë që kjo nuk njihet në botën e jashtme, sidomos në Perëndim, dhe Tito ishte

<sup>30</sup> Johanna Granville, “The Soviet-Yugoslav Detente, Belgrade-Budapest Relations, and the Hungarian Revolution (1955-56),” *Hungarian Studies Review*, Vol. XXIV, Nos. 1-2, 1997, f. 16-19.

<sup>31</sup> S. Rajak, “Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957...”, f. 196.

<sup>32</sup> Po aty, f. 253.

<sup>33</sup> J. Granville, “The Soviet-Yugoslav Detente...”, f. 17.

<sup>34</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 38-39.

trumbetuar si shpëtimtar i Shqipërisë. Ndryshe nga vendet e tjera, në Shqipëri kishte pasur dy lloje të dënuarish: deri më 1948 dënoheshe nëse flisje kundër Jugosllavisë dhe Titos, pas 1948-ës mund të dënoheshe nëse flisje pro Jugosllavisë dhe Titos. Nako Spiru, ministër i Ekonomisë, që konsiderohej se po bëhej pengesë në bashkëpunimin me Jugosllavinë, u detyrua të vriste veten më 1947 (ose e vranë), ndërsa dy vjet më vonë Koçi Xoxe u ekzekutua si agjent i Jugosllavisë. Veç kësaj, Jugosllavia ishte vend kufitar me Shqipërinë, aty ishin strehuar shumë kundërshtarë të regjimit të Tiranës, dhe Hoxha kishte frikë se Tito mund t'i përdorte ata për rrëzimin e tij nga pushteti. Edhe shumë vite më vonë, megjithëse kontaktet mes dy vendeve ishin minimale, jugosllavët ishin në gjendje të merrnin vesh çfarë ndodhte në korridoret e politikës së Tiranës,<sup>35</sup> shumë më herët se gjërat të bëheshin publike.

Enver Hoxha i trembej afrimit me Jugosllavinë, sepse një gjë e tillë do të çonte në rehabilitimin e gjithë të dënuarve titistë në vendet e Bllokut, përfshi Koçi Xoxen.<sup>36</sup> Megjithatë, Hoxha bëri një lojë të dyfishtë, nga njëra anë shprehu shqetësimin e tij për afrimin me Jugosllavinë, nga ana tjetër respektoi porosinë e Hrushovit, për të gjitha vendet satelite, që të tërhiqnin akuzat kundër PKJ të bëra pas 1949-ës. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 20 qershor 1955, Hoxha porositi që të tërhiqeshin nga qarkullimi materiale me përmbajtje antijugosllave. Ai urdhëroi krijimin e një komisioni që do të merrej me identifikimin e materialeve me gjuhë antititiste, ku përdoreshin përshkrime si tradhtar, klika trockiste, banditi, juda, etj., dhe të hiqeshin nga qarkullimi. Ai propozoi gjithashtu që në shkolla të flitej për gabimet e jugosllavëve me fakte, por të hiqeshin epitetet negative. Hoxha porositi pastrimin e librave të bibliotekave nga epitetet negative, por, për këto libra, ambasadori sovjetik kishte thënë të mos prekeshin.<sup>37</sup> Megjithatë, Jugosllavia nuk ishte e kënaqur me progresin e Tiranës në marrëdhëniet dypalëshe, ajo kërkonte që KQ i PPSH të pranonte me një komunikatë që Jugosllavia nuk kishte pasur gabime kundrejt Shqipërisë në vitet 1945-48 dhe të tërhiqej nga deklaratat që kishte bërë deri atëherë kundër saj.

<sup>35</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 14/SKR, viti (më tej: V.) 1960, dosja (më tej: D.) 538, fl. 2. Informacion mbi një takim të Labo Abazit me atasheun e ambasadës çekosllloake Jarosllav Shus, 19 nëntor 1960.

<sup>36</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 35.

<sup>37</sup> *Po aty*, f. 161-162.

Jugosllavët mendonin se gjërat ecnin me vështirësi dhe se në Shqipëri kishte kult individit më shumë se kudo tjetër,<sup>38</sup> mendim që e shprehën dhe sovjetikët më 1961.<sup>39</sup> Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë mbetën problematike, sidomos në nivel politik, dhe jugosllavët bënë fajtor për këtë palën shqiptare, sidomos “udhëheqjen e tanishme,”<sup>40</sup> e cila, në fakt, ishte e njëjtë që nga viti 1944 e deri në mesin e viteve 1980. Hoxha, nga ana e tij, quajti përfundimtar qëndrimin që mbajti ndaj Jugosllavisë në Kongresin III (1956).

Në lidhje me marrëdhëniet e Jugosllavisë, Moska vepronte me kujdes. Hrushovi i kishte thënë Titos se ajo që i lejohej Jugosllavisë nuk do t’u lejohej vendeve të tjera.<sup>41</sup> Në shtator 1956, Moska u dërgoi vendeve satelite një direktivë ku u thoshte hapur se model për zhvillimin e vendeve satelite duhet të ishte BS dhe jo Jugosllavia.<sup>42</sup>

Hoxha vazhdonte me strategjinë e tij, duke u ankuar, sidomos gjatë vitit 1956 e më pas, te ambasadori sovjetik, se misioni jugosllav në Tiranë përpunonte me zell njerëz kundër pushtetit.<sup>43</sup> Ndërkohë ai vazhdonte të spastronte elementët e pakënaqur, siç ishte rasti i Dali Ndreut dhe Liri Gegës, që mund të shfrytëzoheshin nga jugosllavët apo të tjerët kundër tij. Më 1956, kur Jugosllavia u akuzua për përfshirje në kundërrevolucionin hungarez, Hoxha doli sërish në skenë si antititist. Më 8 nëntor 1956, me rastin e 15-vjetorit të themelimit të PKSH, “Pravda” botoi një artikull të firmosur nga Enver Hoxha, i cili kritikoi “ata që pretendojnë se kanë shpikur “forma” dhe “organizime të reja” të sistemit socialist, që aspirojnë t’ua imponojnë të tjerëve dhe predikojnë largimin nga shembulli dhe përvoja e Bashkimit Sovjetik.” Indirekt Hoxha akuzoi Titon se kishte “krijuar kultin e tij të individit” me pretekstin se luftonte kundër kultit të Stalinit. Jugosllavët nuk kishin dyshim që artikulli ishte botuar me lejen e udhëheqjes sovjetike.<sup>44</sup> Më tej, marrëdhëniet e

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 108, 181.

<sup>39</sup> *AQSH*, F. 14/SKR, V. 1961, D. 3, fl. 175-176. Letër e KQ të PKBS dërguar KQ të PPSH, 24 gusht 1961.

<sup>40</sup> Hamit Kaba, Ethem Çeku (përgatitës të botimit), *Shqipëria dhe Kosova në arkivat ruse (1946-1962)*, Prishtinë: Brezi 81, 2011, f. 181.

<sup>41</sup> S. Rajak, “Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957...”, f. 256-57.

<sup>42</sup> Raymond L. Garthoff, “The Tragedy of Hungary”, *Problems of Communism*, January 1957, f. 4. Adresa (9 maj 2016):

<http://www.unz.org/Pub/ProblemsCommunism-1957jan-00003>

<sup>43</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 109.

<sup>44</sup> S. Rajak, “Yugoslav-Soviet Relations, 1953-1957...”, f. 297.

Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë vazhduan me ulje ngritje, por asnjëherë nuk u acaruan në pikën e ndërprerjes së plotë të tyre. Megjithëse Jugosllavia nuk e firmosi Deklaratën e Moskës (nëntor 1957), Hrushovi, kur erdhi në Shqipëri më 1959, u vuri kusht shqiptarëve që të mos flisnin kundër Jugosllavisë gjatë vizitës së tij. Më 1960, Hrushovi i tha Hoxhës se dallimet mes tyre në lidhje me Jugosllavinë ishin taktike, jo parimore. Sipas Hrushovit, sovjetikët nuk i sulmonin jugosllavët ngaqë mendonin se kjo veç do të ngrinte “çmimin e tyre.”<sup>45</sup>

### **Zhvillimet në Bllokun Komunist nën ndikimin e Kongresit XX të PKBS**

Në shkurt 1956, PKBS mbajti Kongresin XX të saj, ndikimi i të cilit u ndie në gjithë Bllokun Komunist. Fjalimi sekret i Hrushovit, që kritikoi kultin e Stalinit, u hapi rrugë partive të vendeve satelite, të cilat frymëzoheshin ideologjikisht nga kongreset e PKBS, të sulmonin udhëheqësit e tyre stalinistë.

Në prill 1956, Partia Komuniste Bullgare mbajti një plenum të veçantë, i cili kritikoi “deformimet dhe devijimet” e kultit të personalitetit të “Stalinit të vogël” të Bullgarisë, Vulko Çervenkov. Kjo çoi në krijimin e një komisioni për hetimin e rasteve të abuzimit me pushtetin, më i njohuri prej të cilëve ishte ekzekutimi i Kostovit si titist, njeriu i tretë në nomenklaturën e partisë. Një numër të dënuarish u liruan nga burgu dhe kampet e internimit, funksionarët e lartë të partisë të dënuar u rehabilituan, partia shpalli me solemnitet një vijë të re që për 30 vitet në vazhdim u njoh si “Vija e Prillit”.<sup>46</sup> Kryeministri Çervenkov dha dorëheqjen dhe vendin e tij e zuri Anton Jugovi, ish-ministër i Brendshëm i shkarkuar në valën antijugosllave të 1949-ës.<sup>47</sup>

Në Poloni, fshatarët ngritën zërin kundër kolektivizimit, kundër dorëzimit të detyruar të prodhimeve bujqësore, u hap fjalë që kolektivizimi do të ndalohej në Poloni dhe gjithë Bllokun e Lindjes, ata u ankuan për mungesën e materialeve të ndërtimit, karburantit, plehrave

<sup>45</sup> *AQSH*, F. 14/Mbledhja e Moskës, V. 1960, D. 30, fl. 210. Regjistrimi i bisedës së delegacioneve të KQ të PKBS dhe të KQ të PPSH, Moskë, 12 nëntor 1960.

<sup>46</sup> Ekaterina Nikova, “Bulgarian Stalinism Revisited”, në: Vladimir Tismaneanu (ed), *Stalinism Revisited: The Establishment of Communist Regimes in East-Central Europe*, Budapest-New York: CEU Press, 2009, f. 284.

<sup>47</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 38-39.

kimike, etj. Fshatarët shfaqën ndjenjat e tyre antisovjetike duke pyetur, për shembull, se kur do të çliroheshin Letonia, Lituania dhe Polonia nga shtypja sovjetike, ose shumë prej tyre kërkuan liri fetare.<sup>48</sup> Unioni i Shkrimtarëve Polakë organizoi një takim të hapur më 27 prill 1956, ku morën pjesë disa qindra vetë. Aty u kritikuan privilegjet e nomenklaturës dhe vuajtjet e masës së gjerë të qytetarëve. U kritikuan dyqanet speciale për udhëheqjen, vilat me shumë dhoma për familje me dy-tre vetë, shtëpitë e pushimeve, e drejta e furnizimit me materiale të veçanta për ushtrinë, shërbimin sekret, administratën, ministrat dhe anëtarët e Komitetit Qendror, dërgimi i fëmijëve të udhëheqësve me makina luksi në shkollë e kopsht, radhët e gjata në spital për të sëmurët, kulti i të paaftit që ishte krijuar nga emërimet që nuk respektonin kualifikimet ose aftësitë.<sup>49</sup> Më 28 qershor 1956, punëtorët e fabrikës së lokomotivave dhe ndërmarrje të tjera industriale në Poznan organizuan një protestë të dhunshme. Nga ndërhyrja e forcave të ushtrisë dhe shërbimit sekret, për shtypjen e protestës që zgjati dy ditë, mbetën 53 të vdekur dhe disa qindra të plagosur. Protestat u shtypën, por kriza nuk u zhduk, dhe vazhdoi gjatë gjithë verës. Në tetor u kthye në parti Vlladisllav Gomulka, i dënuar gjatë spastrimeve staliniste më 1949 e në vazhdim, dhe po bëhej gati të merrte drejtimin e partisë. Kjo i shqetësoi sovjetikët, ngaqë mendonin se Gomulka do të largonte nga drejtimi anëtarët prosovjetikë të udhëheqjes së partisë, ndaj sovjetikët ushtruan presion ushtarak e politik. Më 19 tetor, Hrushovi urdhëroi forcat ushtarake sovjetike në veri dhe përfundim të Polonisë të niseshin drejt Varshavës dhe, pak më pas, një delegacion i nivelit të lartë, politik dhe ushtarak, i kryesuar nga Hrushovi, vizitoi Varshavën. Sovjetikët shprehën shqetësimin për ndryshimet e pritshme në Partinë e Punëtorëve të Bashkuar Polakë, dhe i bënë thirrje udhëheqjes polake të forconte lidhjet politike, ekonomike, dhe ushtarake me BS. Gomulka kërkoi qartësimin e pozicionit të trupave sovjetike në Poloni, kërkoi që BS të mos ndërhynte në punët e brendshme, garantoi qëndrimin e Polonisë në Paktin e Varshavës, por pa lejuar cenimin e pavarësisë së saj, kërkoi largimin e gjithë këshilltarëve sovjetikë ose pjesës më të madhe të tyre (50 gjithsej) dhe largimin nga ushtria polake të ministrit të Mbrojtjes, një besnik i Moskës, dhe disa oficerëve të lartë. Gjatë

<sup>48</sup> A. Kemp-Welch, *Poland under Communism: A Cold War History*, Cambridge: Cambridge University Press, 2008, f. 80-81.

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 81-82.

zhvillimit të bisedimeve me sovjetikët, trupat sovjetike iu afruan Varshavës dhe vendi ishte gati të zhytej në një luftë civile dhe luftë me sovjetikët, por, me insistimin e Gomulkës, Hrushovi dha urdhër për tërheqjen e trupave. Nga bisedimet me Gomulkën dhe fjalimet publike të tij, Hrushovi u bind që Polonia do të qëndronte anëtare e Kampit Socialist dhe Traktatit të Varshavës.<sup>50</sup>

Vendosmëria e Gomulkës për të ruajtur sistemin komunist në Poloni dhe për të qëndruar brenda Traktatit të Varshavës pati ndikim të madh në qëndrimin sovjetik gjatë revolucionit hungarez. Rezultati i krizës polake tregoi që sovjetikët ishin të gatshëm të tregoheshin elastikë, por, kur u duhej, mund t'i përdornin pa mëdyshe metodat staliniste. Nëse Gomulka nuk do të kishte pranuar ta mbante Poloninë brenda bllokut sovjetik, atëherë përplasja ushtarake me sovjetikët do të kishte qenë e pashmangshme, siç ndodhi në Hungari.<sup>51</sup>

Protestat në Hungari, të njohura si Revolucioni Hungarez, ndodhën në vjeshtë 1956, por origjina e tyre ishte rehabilitimi i heshtur i Lazlo Rajkut më 29 mars 1956, i cili u bë nga njeriu përgjegjës për ekzekutimin e tij. Në maj, Rakosi u kritikua hapur në shtyp dhe në korrik u largua si Sekretar i Parë i partisë, vendin e tij e zuri Ernoe Gero. Më 6 tetor, Rajku u zhvarros dhe u organizua një funeral madhështor, ku morën pjesë rreth 200 mijë hungarezë. Më 13 tetor, Imre Nagy u kthye në parti dhe regjimi njoftoi arrestimin e Mihali Farkas, ish-ministër i mbrojtjes dhe shef i policisë sekrete në kohën e Rakosit, i cili ishte përjashtuar nga partia pak ditë pas rënies së Rakosit. Më 20 tetor, tre mijë studentë në Universitetin e Segdit u shkëputën nga organizata komuniste e rinisë dhe po atë ditë gazeta e partisë shkroi për nevojën e “rrugës hungareze drejt socializmit”. Më 21 tetor, studentët e tre universiteteve kërkuan më shumë liri personale dhe kombëtare. Më tej protestat popullore kërkonin lirimin e kardinalit Mindzenti, kthimin e Imre Nagit në qeveri, tërheqjen e plotë të trupave sovjetike; Radio Budapesti kërkoi që Hungaria të ndiqte modelin e Polonisë, e cila sapo kishte nisur me Gomulkën një kurs komunist “të pavarur.”<sup>52</sup> Në radio u dërgua për transmetim një deklaratë me 16

<sup>50</sup> Mark Kramer, “New evidence on Soviet decision-making and the 1956 Polish and Hungarian crises”, *Cold War International History Project Bulletin*, Issues 8-9, Winter 1996/1997, f. 360-362. Adresa (30 mars 2017):

[https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/CWIHPBulletin8-9\\_p6.pdf](https://www.wilsoncenter.org/sites/default/files/CWIHPBulletin8-9_p6.pdf)

<sup>51</sup> Po aty, f. 362.

<sup>52</sup> R. L. Garthoff, “The Tragedy of Hungary...”, f. 4-5.

kërkesa, ku mes të tjerave, kërkohej largimi i menjëhershëm i trupave sovjetike, zhvillimi i zgjedhjeve me votë të fshehtë dhe me pjesëmarrjen e gjithë partive politike. Statuja prej bronzi e Stalinit u çmontua dhe u tërhoq zvarrë nëpër qytet. Pas disa ditësh hezitim, Nagi filloi të plotësonte kërkesat e protestuesve. Më 29 tetor 1956, qeveria e tij bëri thirrje për largimin e trupave sovjetike dhe shpërbërjen e shërbimit informativ të brendshëm. Të nesërmen u deklarua se do të vendosej sistemi politik shumëpartiak dhe do të zhvilloheshin zgjedhje parlamentare të lira e të fshehta. Do të krijoheshin një qeveri koalicioni me partitë e formuara pas 1945-ës. Në fillim BS reagoi butë, të ndikuar, sipas A. Kemp Welch, nga pikëpamja e kinezëve që marrëdhëniet ndërshtetërore duhet të bazoheshin në pesë parimet e Pancha Shila-s.<sup>53</sup> Në kujtimet e tij, Hrushovi thotë që me kinezët ranë dakord për mosndërhyrje ushtarake në Hungari.<sup>54</sup> Duke krahasuar Poloninë dhe Hungarinë, Mark Kramer<sup>55</sup> thotë se Gomulka bëri atë që Nagi nuk e bëri dot, ai e mbajti Poloninë qartësisht brenda bllokut sovjetik, duke shmangur kështu përplasjen ushtarake. Në fillim sovjetikët shpresuan që Nagi të bënte në Hungari atë që Gomulka e bëri në Poloni, por shpejt arritën në përfundimin që gjendja e dy vendeve s'kishte të krahasuar dhe Nagi po kthehej kundër tyre.<sup>56</sup>

Udhëheqësit sovjetikë kishin frikë se Revolucioni Hungarez mund të përhapej në vendet e tjera evropiano-lindore e ndoshta dhe në vetë Bashkimin Sovjetik. Kjo frikë ishte nxitur nga një varg raportesh informative nga Rumania dhe Çekosllovakia. Në shumë qytete rumune u organizuan protesta në mbështetje të Revolucionit Hungarez dhe regjimi rumun u detyrua të ndërmerre masa sigurie emergjente. Protesta me frymë antisovjetike, në mbështetje të revolucionit të hungarez, u mbajtën

<sup>53</sup> *Pancha Shila* [Pesë Parimet] ishin parimet bazë të marrëdhënieve mes Kinës dhe Indisë të formuluar për herë të parë më 1954. Këto parime ishin: respektim i integritetit territorial; mosndërhyrja në punët e brendshme; bashkëpunim mbi bazën e barazisë dhe interesit të përbashkët; mosulmimi dhe bashkëjetesa paqësore. Parimi i fundit, që PKBS e përqafoi në vjeshtën e 1956-ës, u bë dhe një nga tiparet dalluese të periudhës së udhëheqjes së Hrushovit. Shih: A. Kemp-Welch, *Poland under Communism...*, f. 111.

<sup>54</sup> Nikita Hrushov, *Kujtime*, përkthimi shqip: Nikolla Sudar, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2006, f. 256.

<sup>55</sup> Mark Kramer: historian, drejtori i revistës shkencore *Journal of Cold War Studies*, pjesë e Harvard Project on Cold War Studies, botim i MIT Press.

<sup>56</sup> M. Kramer, "New evidence...", f. 362.

dhe në Çekosllovakia. Protesta u zhvilluan dhe brenda Bashkimit Sovjetik, si në Gjeorgji. Në shumë qytete studentët kërkonin largimin e trupave sovjetike nga Hungaria, dhe kjo u bë aq problem sa Presidiumi i PKBS mori vendim për “spastrimin e institucioneve të arsimit të lartë nga elementët e padëshiruar.”<sup>57</sup> Në lidhje me faktorët e jashtëm, A. Kemp Welsh citon Hrushovin: “Nëse largohemi nga Hungaria kjo do t’i jepte kurajë imperializmit amerikan, anglez dhe francez.”<sup>58</sup>

Në Shqipëri, ndikimi i Kongresit XX u reflektua menjëherë, si në shumicën e vendeve satelite, por fundi i tij ishte i shpejtë. Më 14-19 prill, u mbajt Konferenca III e Komitetit të PPSH së Tiranës, ku pjesëmarrësit shfaqën të njëjtat shqetësime si në Bullgari e Poloni. Ata kritikuan udhëheqjen e partisë për gjendjen e rëndë ekonomike të popullit, për privilegjet – autovetura, dyqane ushqimore speciale – që i kishte siguruar vetes, për heshtjen ndaj çështjes së Koçi Xoxes, etj.<sup>59</sup> Enver Hoxha ndërpreu pushimet në Vlorë, dhe nga i akuzuar u kthye në akuzues ndaj “disa elementëve të sëmurë me qëndrime të theksuara antiparti,” që ishin përpjekur “të goditnin unitetin e Partisë” dhe “udhëheqjen e saj”,<sup>60</sup> megjithëse anëtarët e konferencës ishin të gjithë anëtarë partie. Për Hoxhën dhe kolegët e tij ekzistenca e varfërisë së popullit nuk ishin ndonjë gjë e panjohur, ata vetë e kishin pranuar këtë fakt më 1953, kur sovjetikët i thirrën në Moskë pikërisht për këtë çështje. Gjatë verës së atij viti, ndërsa vëmendja e Moskës dhe vendeve të tjera ishte te zhvillimet në Poloni dhe Hungari, Hoxha i spastroi në heshtje autorët e pyetjeve “provokuese” dhe “armiçësore”, siç i etiketoi “Zëri i Popullit” një javë pas konferencës.<sup>61</sup> Në javët që pasuan organizatat-bazë të partisë organizuan mbledhje për dënimin e “punës armiçësore dhe komplotuese ndaj udhëheqjes së partisë”. Më 5 maj 1956, organizata e partisë së Tiranës përjashtoi 13 vetë dhe përndjekja e tyre dhe e shumë të tjerëve vazhdoi me forma të tjera. Shumica e tyre vazhduan të ndiqeshin nga Sigurimi i Shtetit edhe shumë vite pas Konferencës së Tiranës.<sup>62</sup>

<sup>57</sup> Po aty, f. 370-371.

<sup>58</sup> A. Kemp-Welch, *Poland under Communism...*, f. 112.

<sup>59</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 171.

<sup>60</sup> Po aty, f. 176.

<sup>61</sup> Po aty, f. 76-77; lexo: Vasfi Baruti (përgatitës botimi), *Ferri komunist i gjyqeve politike, Tuk Jakova-Bedri Spahiu*, libri 1, Tiranë: ISKK, 2016.

<sup>62</sup> A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 303.

Me trajtimin që i bëri Konferencës së Tiranës, Hoxha mori masat për garantimin e shtypjes së elementëve të cilët, të nxitur nga fryma e “Kursit të Ri”, mund të kërkonin ndryshime në realitetin shqiptar. Taktika e tij arriti dy objektiva: eliminoi përkrahësit realë të frymës së re dhe frikësoi ata që mund të guxonin në të ardhmen të flisnin kundër udhëheqjes, dhe, nga ana tjetër, i tregoi udhëheqjes së PPSH se fati i tyre ishte i përbashkët, ata ose qëndronin ose binin bashkë.<sup>63</sup> Kjo nuk ishte hera e parë që Hoxha godiste para se gjendja e padëshiruar prej tij të dilte jashtë kontrollit. Ai i shtypi që në origjinë përpjekjet e anëtarëve të Byrosë për të luftuar “kultin e individit”, duke dënuar Tuk Jakovën dhe Bedri Spahiun më 1955. Tuk Jakova kishte folur, dhe ato që kishte thënë reflektonin frymën politike që vinte nga Moska. Ai ishte shprehur se në historinë e PKSH duhej t’i jepej vendi që meritonte Miladin Popoviçit, si themelues i saj, një shqetësim që i përmbledhonte të dyja, luftën kundër “kultit të individit” dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë. Jakova, vetë një nga anëtarët e mbledhjes themeluese të PKSH, kishte thënë se themeluesi i partisë nuk ishte Enver Hoxha, siç paraqitej nga propaganda, dhe se roli i themeluesit të PKSH i takonte Miladin Popoviçit. Ai u përjashtua nga partia, së bashku me Bedri Spahiun, dhe më vonë të dy u burgosën.<sup>64</sup>

Hoxha dhe George Dezhi i Rumanisë ishin dy stalinistët më të sukseshëm në Bllokun Komunist në këtë periudhë. Në prill 1954, kur vendet satelite nisën të krijonin udhëheqjen kolektive me sugjerimin e Moskës, në Rumani u ekzekutua, “pas një gjyqi farsë”, rivali politik i Dezhit brenda partisë, Lukretiu Patrascanu. Një ditë pas ekzekutimit, PPR mbajti plenumin që mori vendimin për krijimin e udhëheqjes kolektive.<sup>65</sup> Me heqjen e Patrascanut, Dezhi zhduku një kundërshtar që mund t’i hapte probleme më vonë, siç ndodhi në vende të tjera ku erdhën në pushtet të dënuarit e dikurshëm si titistë ose liderë të rinj. Ekzistonte frika, që në një moment të caktuar, Moska mund t’i përdorte rivalët e stalinistëve kundër tyre. Në kujtimet e tij, Enver Hoxha shkruan se Hrushovi u kishte hapur dritën jeshile gjithë elementëve revizionistë, që

<sup>63</sup> *Po aty*, f. 64.

<sup>64</sup> *AQSH*, F. 14/OU, V. 1955, D. 19, fl. 94-132. Raport i Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 11 qershor 1955. Shih “Bisedë e Rita Markos, sekretar i KQ të PPSH, me Rrapo Baxhulin, pedagog në Shkollën e Partisë”, në A. Lalaj, *Pranvera e rrejtshme...*, f. 135-137.

<sup>65</sup> V. Tismaneanu (ed), *Stalinism Revisited...*, f. 200-201.

deri atëherë kishin qëndruar të tulatur, duke pritur “momentet e përshtatshme”, dhe këto momente po i krijonte, sipas tij, Hrushovi.<sup>66</sup> Hoxha dhe Dezhi, të cilët i spastruan me rreptësi të entuziazmuarit nga fryma e “Kursit të Ri”, ia dolën t’u mbijetonin ndryshimeve që ndodhën në Bllokun Komunist gjatë vitit 1956. Veç tyre, pa u cenuar doli dhe udhëheqësi gjerman, Walter Ulbricht, por çështja gjermane ishte e veçantë, për shkak të ndarjes së vendit, dhe Moska nuk ishte e interesuar të krijonte atje probleme shtesë.

Politika e “Kursit të Ri” të Moskës nxori në sipërfaqe pakënaqësitë dhe inatet politike që ekzistonin në Bllokun Komunist, i cili deri atëherë ishte mbajtur i bashkuar nga dora e hekurt e Stalinit. Kritikkat që u shfaqën ndaj drejtuesve politikë në të gjitha vendet, në disa prej të cilave u kthyen në protesta, treguan që, nëse popujt do të ishin të lirë, ata do t’i reformonin ose dhe ndryshonin rrënjësisht regjimet e tyre, si dhe do t’i përzinin forcat ushtarake sovjetike nga vendi i tyre. Krisja e unitetit të vendeve socialiste menjëherë pas goditjes së mitit të Stalinit dhe stalinistëve nxori në dukje cektësinë e ndryshimeve që premtoi politika e “Kursit të Ri”. Drejtuesit e rinj të PKBS, pavarësisht ndryshimeve që kërkonin të bëheshin në vendet socialiste, përmes reformave apo ndërrimit të drejtuesve të tyre, me këtë nënkuptonin ndryshime që nuk cenonin rendin gjeopolitik të kampit të ndërtuar nga Stalini: Bashkimi Sovjetik në krye dhe vendet e tjera të bashkuar rreth tij. Pak muaj më vonë (mars 1958), Hrushovi shkeli dhe parimin e udhëheqjes kolektive, duke marrë dhe postin e kryeministrit të BS, ndërkohë që ishte sekretar i Përgjithshëm i PKBS.

Në përpjekje për të rregulluar imazhin e bllokut të trazuar nga ngjarjet e vitit 1956, i cili u mbajt i bashkuar me ndërhyrjen e Ushtrisë së Kuqe, Moska organizoi një mbledhje të partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste, 14-16 nëntor 1957, e cila në literaturën e kohës njihet si Konferenca e Moskës. Në deklaratën që doli nga kjo konferencë thuhej se të gjitha partitë komuniste e punëtore duhet “të përkrahin Bashkimin Sovjetik dhe të gjitha vendet socialiste”. Më tej, thuhej se vendet socialiste i ndërtojnë marrëdhëniet e tyre reciproke “mbi parimet e barazisë së plotë, të respektit të integritetit tokësor, të pavarësisë

<sup>66</sup> Enver Hoxha, *Hrushovianët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1980, f. 37-38.

shtetërore, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit.”<sup>67</sup> Kjo ngjante ironike, sepse një vit më parë Bashkimi Sovjetik kishte shtypur ushtarakisht Revolucionin Hungarez dhe mori peng ish-kryeministrin e tyre. Më shumë se për marrëdhëniet e tij me vendet socialiste, Bashkimi Sovjetik ishte i interesuar për imazhin e tij në arenën ndërkombëtare. Uniteti i vendeve socialiste, i prezantuar me një deklaratë, i jepte atij më shumë fuqi në rivalitetin me vendet perëndimore, sidomos SHBA, në zgjidhjen e çështjes gjermane dhe të tjera. Deklarata e Moskës nuk u firmos nga jugosllavët, ndërsa kinezët e firmosën, por, siç thanë më vonë, këtë e bënë për hir të unitetit,<sup>68</sup> i cili nuk zgjati shumë. Prishja e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe kalimi i saj nën mbështetjen e Kinës, tregoi që krisja e unitetit të kampit ishte e pariparueshme.

### *S u m m a r y*

#### THE POLITICAL DEVELOPMENTS IN EASTERN EUROPE (1953-1960)

Stalin's death was followed by changes in the Soviet leadership and policy which were applied immediately by the other socialist countries of Eastern Europe, including Albania. This article dwells exactly on these developments and the influence of the new Soviet policy in Albania compared to other Soviet satellite states. In Albania just like in the other countries Moscow policy was transmitted by direct messages or imitation spirit of what was happening in Moscow without direct intervention of the Soviets. Still, despite the changes, one thing remained constant for the whole camp: The leading role of the Soviet Union. The leaders of the satellite states were summoned to Moscow when they reported on the situation of their countries and took advice which was in fact orders. This article deals specifically with the question of economy, the new attitude toward Yugoslavia and the de-Stalinization. In some of the other countries during this period changes took place in the parties' leadership, a

<sup>67</sup> *Deklaratë e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve socialistike*, 14-16 nëntor 1957, Tiranë: Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957, f. 12.

<sup>68</sup> *AQSH*, F. 14/Mbledhja e Bukureshtit, V. 1960, D. 8, fl. 22-23. Raport mbi zhvillimin e punimeve në Mbledhjen e Bukureshtit midis përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtoresh.

movement which effected a lot the application of Moscow orders by the leaders of the Party of Labor of Albania. The main concern of the Albanian leaders remained how to keep their personal power and this approach shaped all the political developments in the country.